

## ANDROGYNY

Kabbalah (përputhja e të kundërtave) është një shkollë mendimesh të brendshme në Xhudaizmin mistik, që synon të sqarojë marrëdhënjen mes të pandryshueshmes (Zotit të përjetshëm), të pashpjegueshmës dhe të vdekshmes (Krijesës së Zotit) atë që merr fund. Është një nga themelet e sqarimeve fetare të të fshehtave brenda Xhudaizmit. Sipas besimtarëve, zanafilla e këtyre mësimëve paradaton të gjitha fetë mbarë botërore, duke shënuar fillësën e mendimit rreth Krijimit të gjithësisë. Këto mësimë gjithashtu, mësohen nga ndjekësit e Xhudaizmit për të përkufizuar kuptimin e brendshëm të Biblës së Hebrenjve, shkrimet tradicionale të priftërinjve hebre si dhe përcimin e përmasës së tyre të fshehur. Kjo traditë e Lashtë Hebraike e sqarimit të mistereve, fillimisht është mbartur gojarisht duke përdorur mënyra të fshehta, të kuptueshme vetëm për një numër të caktuar njerëzish me një nivel të caktuar njohurish (duke përfshirë kode). Kjo shkollë mendimesh, kulmin e ndikimit e pati nga fundi i Mesjetës, kur u pasqyrua për herë të parë në një libër të botuar me titullin: *Zohar*, dhe nën titullin: *Libri i shkëlqimit*. Libri u botua në Spanjën e shekulli të trembëdhjetë në gjuhën Aramisht. Ai libër përmban shpjegime të pikëpamjeve rreth të fshehtave të Toras së Moisiut dhe sqarime shpirtërore, gjëra të tilla si natyra e Zotit, shpirtit, drita e Perëndisë, ndërtimi i gjithësisë etj. Gershom Scholem (1897-1982), ati i njohurive rreth Kabbalah, e quajti Zohar një “novelë origjinale” që rrëfen bëmat kryq e tërthorë në tokën Izraelite të shekullit të dytë. Me pak fjalë, dy mjeshtra endacakë, përgjatë një përroi, nën hijen e një peme apo brenda kamares së një shpelle, ecin dhe flasin së bashku duke shpalosur të fshehtat më të thella dhe të pashpjegueshme të Tora-s, gjithësisë, si dhe të Zotit. Mendimi i përgjithshëm i Xhudaizmit tradicional është se mësimet e Kabbalah-s janë shpallur nga Zoti përmes figurave të njohura biblike si Abrahami dhe Moisiu. Një nga të vërtetat e këtyre mësimëve është se Krijuesi i Plotfuqishëm është femëror aq sa ç’është dhe mashkullor, pra një *androgyny* e përkryer. Me kalimin e kohës kjo do të njihej si një nga shtatë parimet e Thot-it ose Hermet-it apo Trismegistit-s, ai që do shfaqej tre here, mjeshtri i artit dhe shkencës, i përkryer në të gjitha zanatet, i vlerësuar nga Egjiptianët e lashtë si mishërimi i mendjes së Gjithësisë. Parimi i përputhjes së të kundërtave thotë pikërisht kështu: Siç është lart është edhe poshtë, siç është poshtë është edhe lart. Siç është nga brenda është edhe nga jashtë, siç është nga jashtë është edhe nga brenda....

\*\*\*

Këto ide të Lashtësisë u ri-zbuluan në shekullin e XV-të dhe të gjitha shkrimet u përkthyen në Latinisht nga konti Cosimo de Medici, gjyshi i Lorenzo de Medici, punë dhënësi i Leonardo da Vinçit dhe artisëve të tjerë. Këto shkrime patën aq ndikim të madh në atë kohë sa që shërbyen si nxitje për mendimtarët e Rilindjes Italianë në kulturë dhe mendësi. Dhe jo më kot da Vinçi është një ndër përfaqësuesit më madhështor. Ai e shfrytëzoi këtë parim në vizatimet e tij (simetrinë). Por, idetë e lashtësisë përmes rilindjes siç e dimë, u përhapën në mbarë Europën. Dhe kur vjen fjala te Kabbalah, përputhja, si lart ashtu edhe poshtë, *androgyny*, dyzimi, bashkimi përmes të kundërtave etj, një ndër ata që më së shumti i shfrytëzoi këto ide të mbartura në trajtë parimi, është edhe Uilliam Shekspir. E gjithë vepra e Shekspirit është e ndërtuar mbi praninë dhe bashkëjetesën e të kundërtave.

Duke qenë se ishte dramaturg dhe si i tillë lëvronte mendjen dhe shpirtin njerëzorë, rastin në fjalë shpalos dyjëzimi brenda qënjes njerëzore. Kjo falë aftësisë së Shekspirit për të kuptuar aftësinë e njeriut për të shfaqur anën femërore apo mashkullore pa marrë parasysh përkatësinë gjinore, si për burrat ashtu edhe për gratë. Ai e shfrytëzoi këtë më së miri, të paktën në komeditë e tij, me qëllim që gazmorja të bëhet edhe më gazmore. Një dukuri mund të mos jetë e ratësishme në dy prej komedive më të mira dhe më të vëna anë skenë ndonjëherë të Shekspirit. Në komedinë “Nata e dymbëdhjetë”, përveç të tjerëve është edhe një personazh me emrin Orsini. Ai shfaqet si një fisnik me mustaqe, i veshur me pelerinë, dhe sillet e flet si burrë, madje shkon deri aty sa të kërcënojë me shpatë etj. Në të vërtetë Orsini është një grua me emrin Olivia e veshur si burrë. Kjo për shkak të rrethanave komike të ngjarjes, të cilat bëhen edhe më qesharake nga fshehja e një gruaje brenda një burri. Vetëm atëherë kur duhet, ne si shikues e marrëm vesh të vërtetën. Te komedia tjetër po aq gazmore “Ëndërra e një nate vere”, gjashtë mjeshtra pylli, vendosin të japin një shfaqje para Mbretit. Mirëpo shfaqja që kanë zgjedhur, ka si personazh kryesor një vajzë të re me emrin Tizbe. Në mungesë të femrës, mungesë e stisur qëllimisht nga Shekspiri, njëri nga mjeshtrat vendos të luajë përpara Mbretit rolin e Tizbes, pra të një femre. Falë rrethanës tejet të veçantë, ajo është njëra prej pjesëve më gazmore të shkruara ndonjëherë nga autori në të gjitha komeditë e tij. Kjo si pasojë e shfrytëzimit më zgjuarsit të parimit të përputhjes së të kundërta brenda karakterit të njeriut. Ky fat tragji-komik i dy dashnorëve, Tizbja dhe Priami, mendohet të jetë pararendëse e njëres prej historive të dashurisë më rrënjëthënëse dhe në zë në mbarë botën, e njohur si Romeo dhe Xhuljeta. Përpunimi i një komedie dhe shndërrimi i saj në tragjedi, që vetëm mendja gjeniale e tij mund ta bënte. Në mënyrë të vetvetishme kaluam te tragjedia. Dhe kur bëhet fjalë për tragjedi, s’mund të gjendet edhe një tjetër po aq madhështore sa Hamleti. Shumë prej kritikëve botërorë e kanë cilësuar si veprën më të madhe skenike të shkruar ndonjëherë. Shekspiri vetë, nuk mund të kuptohet pa Hamletin, ose e thënë ndryshe, të kuptosh Shekspirit duhet të kuptosh Hamletin. Nëse lexojmë Hamletin, dhe nëse kemi pasur rastin ta shohim në skenë aq më mirë, gjatë gjithë kohës përveç tjerash përjetojmë ndjenjën e pasigurisë. Pasiguri që mbartet te lexuesi ose shikuesi përmes vetë personazhit kryesor. Hamleti vret këshiltarin e Mbretit që përgjon prapa perdes. E vret me qëllim apo padashje? A është Hamleti trim apo frikacak, dinak apo i trashë, dashuron apo urren, a është ai pro apo kundër gjakderdhjes??? Të jesh apo të mos jesh... Do bëhem i keq, për t’u bërë i mirë... Druaj yjet janë zjarr, druaj dielli nuk ndryshon, druaj jeta është varr... të gjitha këto janë shfaqje e qartë e përputhjes së të kundërtave në mendësinë e Hamletit, mendësi e dyzuar, *andorgyny*, siç ëahtë jashtë, ashtu është edhe brenda. Ne s’e marrim vesh kurrë nëse ai vërtetë e do Ofelinë, madje edhe vetë ajo nuk e kupton dhe ndoshta për këtë arsye ka një fund tragjik në vepër. Ëndërra e çdo aktori është që të paktën një herë në jetë të luajë Hamletin. Kjo sepse të luash Hamletin do të thotë të luash gjithçka tjetër, si pasojë e ndërlikimit dhe vështirësisë që ka vetë roli. Pa marrë parasysh, kjo se ka penguar aktoren Irlandeze Bandman Palmer ta luajtë Hamletin. Në fillim të shekullit të kaluar ajo interpretoi Hamletin në skenë katërqind e tetëdhjetë herë rresht.

Deri tani kemi folur për përputhjen e të kundërtave në dukuritë e padukshme dhe të paprekshme, siç ishte mëdyshje e mendjes njerëzore te Hamleti. Kjo mund të mos jetë edhe aq bindëse për ata që mund ti shohin me përçmim parimet e Hermetit. Prandaj, le të shkëputemi nga fusha e shkencave shoqërore për një çast dhe të shohim sesi ky parim mishërohet në fushën e fizikës, si një nga shkencat e sakta më të rëndësishme. De Broglie, duke hulumtuar natyrën e dritës vërtetoi

se në vartësi të eksperimentit të përthyerjes, drita domosdoshmërisht duhet të përshkruhet si valë elektromagnetike ose si grimcë (foton). Falë punës së tij dhe shkencëtarëve të tjerë si Nils Bor apo Albert Ajnshtajn, dualiteti valë-thërmijë, është mëse i njohur dhe i pranuar shkencërisht. Ndaj thotë Walter Greiner, - ajo çfarë është e vërtetë për fotonet e dritës, duhet të jetë e vërtetë për çdo lloj thërmije. E solla këtë shembull thjesht për të rikujtuar teorinë e dualizmit valë-thërmijë, që tashmë të gjithë e dimë, si dhe për të parë se si përputhja e të kundërtave shtrihet në shumë fusha të ndryshme të jetës. Siç mund të jetë fjala vjen edhe fizionomia e njeriut. Nëse shohim veçoritë e fytyrës të njeriut nga lindja deri në vdekje në një hark kohor 70-80 vjet, do shohim të mishëruar qartë këtë dukuri, tiparet e fytyrës herë anojnë nga mashkullorja, herë nga femërorja. Pra, dyjëzimi brenda njeriut nuk është vetën çështje gjinie, burrë dhe grua, është edhe fizionomi, e më e rëndësishmja mendësi kundrejt çdo gjëje të dukshme dhe të padukshme. Mirëpo është edhe çështje ndjesie. Sa herë na qëllon që të jemi ndjerë tepër të lumtur dhe mandej tepër të trishtuar, madje shpesh herë pa ndonjë arsye të veçantë?!

Si është mishëruar kjo dukuri në jetën shqiptare? Për kërë do sjell dy shembuj të thjeshtë. Në veri të vendit, të paktën dri në vitet 90' të shekullit të kaluar, në çdo dasëm përveç tjerash kërcehej edhe vallja gazmore e plakut dhe plakës. Në mungesë të një skene teatri të përshtatshme, dasmat shqiptare ndër shekuj janë shfrytëzuar përveç tjerash edhe si rast i mirë për t'u argëtuar. Këtë qëllim e përmbush edhe vallja e plakut më plakën, ku në këtë rast plakën e luan një burrë, gjë që i shërben gazmores dhe argëtimit. E parë nga këndvështrimi femëror, kjo dukuri spikat më së mirë në rastin e grave të tilla shqiptare si Bubullima, Nora e Kelmendit apo Shote Galica, të cilat për nga trimëria mund ti kenë bërë jo pak burra shqiptarë të ndjehen të turpëruar.

\*\*\*

*Fjalori me sqarime madhështore*, botuar nga mesi i viteve 80' të shekullit të shkuar, është një nga punët më të rëndësishme në fushën e gjuhësisë angleze. Punim me afërsisht 1920 faqe A-4, i cili është botuar njëkohësisht në Londër, Nju Jork, Sidnej, Kejptaun dhe Montreal, në dy vëllime të veçanta. Për këtë fjalor janë angazhuar me punën e tyre, profesorë/doktorë, nga fushat e shkencës së gjuhësisë, tingujve, pasurisë së fjalëve, dhe etimologjisë, nga universitete më në zë të Britanisë si Universiteti i Redingut dhe ai i Kolegjit të Londrës.

Sipas këtij fjalori, *androgyny* përcaktohet si emër. Mirëpo megjithë se i shkruar në fjalor, nuk sqarohet në cilësinë e emrit, dhe që këtu fillojnë dyshimi i parë. Sqarimi i këtij emri, bëhet përmes një fjale më përpara kësaj *androgynous* e përcaktuar si mbiemër dhe saktësisht: *androgynous* = të kesh që të dyja veçoritë femrore dhe mashkullore – *androgynous* (anglisht) = *androgynus* (latinisht) = *androgynos* (greqisht). Po sipas këtij fjalori, *andro-* *andr* = tipar mashkullor, dhe që përdorer si emër për burrat. *Andrew* (anglisht) = *Andreas* (latin). Në greqisht megjithatë, nuk janë të sigurtë për prejardhjen dhe thonë shprehimisht: ndoshta nga *andreious* (burrëror) ose *anër*(burrë). Të kesh të dyja veçoritë femrore dhe mashkullore, mendoj unë, është përcaktimi më i përgjithshëm dhe i tkurrur brenda një hapësire të ngushtë, i cili hap shtegun e hamendësimeve të shumta. Nëse bëhet fjalë për prirjet seksuale, atëherë epshi është një shfaqje e veçorisë shtazore më shumë sesa njerzore, tek njeriu, një arsye më shumë për paqartësi.

Katërqind vjet më parë, Francis Bacon, filozof, burrë shteti, eseist, dhe kampion i përvojës jetësore dhe metodikës shkencore, bëri thirrje për një lëvizje rrënjësore larg nga tradita shkollore

e burgosur nga argumente dhe mbështetje te autoriteti. Përfundimi i tij rreth çoroditjes së shkaktuar nga fjalët vlen të përmendet plotësisht në këtë punim:

*“Tani fjalët, duke u përshtatur dhe zbatuar zakonisht sipas aftësisë së të rëndomtit, ndjekin po ato linja ndarjeje që janë më të dukshme për kuptimin e rëndomtë.”*

Dyshoj se sqarimi i fjalorit të sipër përmendur është një përshtatje sipas aftësisë së të rëndomtit, femër/mashkull, dhe për të ndjekur atë linja mendimi më të dukshme për kuptimin e rëndomtë. Nga ana tjetër, duke qenë një nga shtatë parimet e Hermetit, ajo çfarë përmban brenda vetes kjo fjalë, ka shumë të ngjarë të jetë më madhështore, dhe më e pakta të jetë ndryshe. Por le ta pranojmë për një çast se kjo fjalë e ndarë qëllimisht në fjalor për arsye studimi në këtë mënyrë: *andro-gyny*, është sqaruar saktë. Ta pranojmë për një çast se *andro* = mashkullor. Për prejardhjen e kësaj fjale jemi të sigurtë vetëm në latinisht, pasi në greqisht kjo fjalë mund të ketë ardhur nga dy burime të ndryshme (gjithmonë sipas fjarorit në fjalë). Ende më pak të sigurtë jemi për faktin nëse është apo jo fjala e duhur. Nëse e shqyrtojmë nga pikëpamja tingëllore, fjala *gyny*, përputhet tërësisht me fjalën shqipe gegnisht *gjini*, me (gj) të shurdhët (*dj*). Pra duket qartë se bëhet fjalë për fjalën *gjini*. Gji = gjini ose gjiri është në mënyrë të padiskutueshme fjalë shqipe, dhe me një përdorim shumë të gjerë. Gji-gjini (i femrës) – Gjini (emër burri) – gjinia (familja) – gjinia (femrore ose mashkullore) – gjini (vend në bregdet) gjitar (kafshët që ushqehen me qumësht në vitet e para të jetës) sipas parimit furrtaar – peshkatat – gjitar. Dhe e fundit, por jo nga rëndësia, gjins – rracë (çfarë lloj gjinsi je ti? – çfarë pjelle je ti?). Pra, për të dytën herë vihet në pikëpyetje kuptimi i asaj që është marrë përsipër për t’u sqaruar.

Një nga dallimet mes këtij fjalori dhe shumicës së fjalorëve të mëparshëm, - thuhet në parathënjën e këtij fjalori - qëndron në pasurinë e vet sa i përket punës së palodhur me sqarimet, secili sqarim i zgjedhur me kujdes për të plotësuar kuptimin e fjalës. Kjo mund të jetë përgjithësisht e vërtetë, por në fq.72 të këtij fjalori ku sqarohet fjala *androgyny*, autorët qëllimisht ose jo, ndryshojnë rregullat e lojës. Nëse emrin *androgyny* e sqajorjën sipas parimit të shkencës së gjuhësisë, paçka se përdorin mbiemrin *androgynous*, ose të paktën bëjnë përpjekje, në po atë faqe kur vjen puna për emrin Andromaka, e mbështesin sqarimin e këtij emri te gojëdhëna sipas tyre greke dhe shprehimisht: Andromaka = sipas gojëdhënës greke, gruaja besnike e Hektorit, e zënë rob pas rënjes së Trojës. E nëse dikush mendon se ky është emër njeriu dhe nuk e kanë parë të arsyeshme ta sqarojnë kuptimin, le të mos harrojmë se edhe emri Andre (mashkullor) është emër njeriu kuptimi i së cilët sqarohet më së miri. I vetmi dallim është se Andre mund të sqarohet lehtësisht nga latinishtja, ndërkohë që Andromaka, është përtej rrezes së aftësive të tyre arsyuese. Ndaj dhe në vend se të përpiqen ta sqarojnë nga ana gjuhësore, i kanë rënë shkurt duke na e rikujtuar përrallën. Kjo më sjell ndërmend një zotëri gjatë kohës së komunizmit në vendlindjen time. Gruaja e tij ishte sekretare partie dhe sa herë që qëllonte që ai të udhëtonte nga fshati drejt qytetës, u nxirrte dorën makinave të rastit dhe u thoshte: - Më merr deri në qytet se jam burri i Soses! Si e ke emrin? - Më quajnë gruaja besnike e Hektorit e zënë rob pas rënjes së Trojës??? Nëse Andromaka ka jetuar ndonjëherë, të tillë e ka pasur emrin, para, gjatë dhe pas luftës së Trojës. Kjo mospërputhje nxjerr në pah një tjetër mangësi. Mohimi njëqind për qind i çfarëdo lloj gjëje qoftë ajo, në dijeninë time më të mirë jo vetëm që nuk është shkencë, por është mungesë pjekurie. Duke mohuar gjuhën shqipe, dhe duke u mbështetur tërësisht në atë që besojnë se është greqishtja e vjetër, këta hulumtues të nderuar, bëhen të pabesueshëm

dhe përmes arsyetimeve të pa mbështetura kundërshtojnë vetveten. Kjo fjalë fatkeqësisht përkthehet në të njëjtën mënyrë edhe në fjalorët e tjerë të gjuhës angleze. Në parim e kanë të pamundur të gabojnë ngaqë iu vjen në ndihmë Kabbalah, pasiqë ky parim tejkalon latinishten dhe greqishten, duke qenë shumë më i hershëm. Gjuha e zgjedhura për ta sqaruar mund të mos jetë e duhura, dhe fjalët e përdorura janë keqkuptuar. Tekembramja, përse ta sqaronin këtë emër përmes mbiemrit dhe të mos merren drejtpërdrejt me emrin, që unë mendoj se ka një kuptim të tillë: androgyny = andro-gyny = a'ndrro – djini = ëndërro - gjini, vegimi, përfytyrimi i gjinisë së kundërt brenda vetes sonë *ëndërrojini*. Sa gjëra përfytyrojmë, dhe ëndërrojme, sa gjëra na shkojnë ndër mend vetëm brenda një dite të vetme?!

Në vitin 1869, një tjetër filozof i mirënjohur European, francezi Hyppolite Taine, thoshte se:

*... “çdo hulumtues mendjehollë i gjuhësisë, gojëdhënave, dhe etnografisë, synon vetëm një gjë, përshkrimin e mendjes njerëzore, apo veçoritë e përbashkëta të një bashkësie mendjesh njerëzore, ndaj dhe ajo çfarë bëjnë historianët me të shkuarën, më së mirë e bëjnë shkrimtarët me të tashmen. Meqë mendja njerzore shprehet përmes gjuhës, dhe meqë ajo që përpiqemi të sqarojmë është dyfjalësh (ënërro-gjini), po sjellim një shembull sqarimi nga pikëpamja psikologjike, sesi bashkimi i dy gjërave në një, sjell tërësisht një kuptim të ri. “*

Nëse themi gurë shahu gjëja e parë që na vjen në mendje janë disa figura të cilat ne jemi mësuar ti quajmë ushtarë, oficerë, kali, etj. Nëse themi fushë shahu, përfytyrimi i parë në mendjen tonë është dërrasë me katrorë bardhe zi ose në dy ngjyra të ndryshme çfarëdo, sipër së cilës vendosen gurët e shahut. Por, nëse themi lojë shahu... atëherë jemi në një nivel krejt tjetër mendor, që prap se prap mishërohet përmes gurëve dhe fushës së shahut. Nivel mendor, larg së qëni i rëndomtë, dhe që nuk i ndjek po ato linja ndarjeje që janë më të dukshme për kuptimin e rëndomtë. Diçka që e sheh mendja dhe që mishërohet përmes syrit, ashtu sikurse edhe gjuha, përmes së cilës shprehim ato gjëra të cilat fillimisht i mendojmë.

*Androgyny*, mund të jetë vetëm një fjalë e vetme, por brenda vetvetes përmban, një ndër shtatë parimet e Hermetit, dhe aq më tepër kur frymon në gjuhën shqipe. Një fjalë sa një fjalë, një fjalë sa gjithë gjuha. Dhe rast i lakmueshëm për ta parë gjuhën tonë jo vetëm nga ana morfologjike, por edhe si shprehje mendimesh përmes përfytyrimit. Ta pranosh gjuhën shqipe si gjuhë parake, përveç teorisë apo doktrinës së mençurisë, nevojitet edhe një teori tjetër shtesë, që thjesht dhe qartë është teoria e Vullnetit.

## LITERATURA

Great Illustrated Dictionary – Introduction

James Joyce – Ulysses, An introduction by Declan Kiberd

A journey into Zohar (An introduction to the book of Radiance) Nathan Wolski.

Nata e dymbëdhjetë – komedi, W. Shakespeare.

Ëndërra e një në nate vere – komedi, W. Shakespeare.

Hamlet by William. Shakespeare.

Francis Bacon - Novum Organum (1620)

Hyppolite Maine On Intelgence (1869), Volume I.

Walter Greiner (2001). *Quantum Mechanics: An Introduction.*